



## VENDIM

*Nr. 35 Datë 10 .04.2013*

### PËR

### FILLIMIN E PROCEDURAVE MBI SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “TEODORI 2003” SH.P.K, PËR LËNIEN PENG TË ASETEVE TË SAJ SI KOLATERAL PRANË BANKES EUROPIANE PER RINDERTIM DHE ZHVILLIM

Në mbështetje të neneve 9 dhe 20 pika “1”, të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, neneve 6, 7 dhe 8, të Rregullores për Procedurat e Transferimit të Aseteve nga të Licensuarit, miratuar me vendimin nr. 89, datë 13.12.2006, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, pikave 1.3 dhe 1.6 të licensës me seri PV10P, “Për Prodhimin e Energjisë Elektrike”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 10.04.2013, mbasi shqyrtoi kërkesën për lënien peng të asetëve si kolateral nga shoqëria “TEODORI 2003” sh.p.k pranë Bankës Europiane per Rindertim dhe Zhvillim, si dhe relacionin e Drejtorisë së Licensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

#### **Konstatoi se:**

Aplikimi i shoqërisë “TEODORI 2003” sh.p.k plotëson kërkesat e parashikura nga ERE në Rregullores për Procedurat e Transferimit të Aseteve nga të Licensuarit si më poshtë:

- Neni 7, pika 1.1 dhe 1.2 Emri dhe adresa e plote e te licensuarit. (Janë paraqitur në mënyrë të plotë dhe korekte.)
- Neni 7, pika 1.3, gërma “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”, “h”, Përshkrimi i të licensuarit dhe informacioni lidhur me aktivitetit e tij. (Ky informacion është dhënë i plotë me të gjitha detajet e kërkuara nga rregullorja.)
- Neni 7, pika 2, 3, 4 dhe 5 (Ky informacion është plotësuar tërësisht.)  
Nuk është paraqitur lista e asetëve per tu lene lene peng si kolateral.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

**VENDOSI :**

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “TEODORI 2003” sh.p.k për lënie peng si kolateral të aseteve të shoqërisë pranë “BERZH”
2. Ngarkohet Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin lidhur me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.  
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Sokol RAMADANI**